

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992) (8)

Takimi i partive në Sarajevë dhe biseda Milosheviq-Karaxhiq

Një bisedë telefonike mes Milosheviqit e Karaxhiqit, incizuar në kohën e takimit në Sarajevë, vërteton se serbët tashmë kishin vendosur që të përdornin forcën në Bosnjë. “Do t’i merrni të gjitha mos u brengosni. Ne jemi më të fortët. Derisa ne të kemi ushtrinë, askush nuk mund të na bëjë asgjë”, i thoshte Milosheviqi Karaxhiqit

Gojko Mishkoviq, bashkëpunëtor në Iniciativën e Shkencëtarëve dëshmon sesi qasja armiqësore e Karaxhiqit ishte futur në ligjëratat në Bosnjë, nga mesi i vitit 1991. Në gusht të atij viti, ai merr pjesë në takimin me përfaqësues të 20 partive politike nga e mbarë Jugosllavia, në Sarajevë, organizuar nga partia e tij, Partia Demokratike e Serbisë.

Atmosfera e takimit ishte e tendosur. Velibor Ostojiq, shefi i delegacionit të Partisë Demokratike Serbe të Bosnjë-Hercegovinës (SDS) mori fjalën i pari. Hapjen ai e nisi me një retorikë të furishme e nxitëse dhe e bëri të qartë se SDS-ja dhe serbët nuk mund të pranojnë as koncesion as kompromis, pasi ishin në vend të vetin. Derisa ai fliste, delegacioni i Partisë Socialiste Serbe dhe Unioni Komunist i Malit të Zi, tundnin kokat në shenjë përkrahjeje. Fill pas tij, përfaqësuesit e Unionit Demokratik Kroat të Bosnjë-Hercegovinës (HDZ) dhe SDA-ja (Partia e Aksionit Demokratik e Izetbegoviqit) u përgjigjën me të njëjtin ton.

Mëngjesin e ardhshëm UJ-ja dhe trupat serbe kishin bombarduar Osijekun duke i dhënë goditjen e fundit përpjekjeve për negociata. Tri javë me vonë, raundi i bisedimeve, ishte një fiasco dhe dështim total. Një bisedë telefonike mes Milosheviqit e Karaxhiqit, incizuar në kohën e takimit në Sarajevë, vërteton se serbët tashmë kishin vendosur që të përdornin forcën në Bosnjë. “Do t’i merrni të gjitha mos u brengosni. Ne jemi më të fortët. Derisa ne të kemi ushtrinë, askush nuk mund të na bëjë

asgjë”, i thoshte Milosheviqi Karaxhiqit. Perëndimi fillimisht besonte se Karaxhiqi dhe liderët e tjerë serbë në Serbi e Bosnjë ishin njerëz racionalë me të cilët mund të negociohet dhe të arrihet kompromis e pajtim. Në fakt ata respektonin vetëm forcën apo kërcënime të prera se ajo do të përdorej. Asnjë shkallë e sigurisë për minoritetin serb në Kroaci e Bosnjë nuk do të zmbrapste Milosheviqin që ta shfrytëzonte arsenalin e Jugosllavisë për qëllime të veta.

Ndonëse në disa raste më i vullnetshëm të dëgjonte qortimet dhe këshillat nga fuqitë perëndimore, Franjo Tuxhman përta përket nacionalizmit krahasohej me Karaxhiqin.

“Ai ka një qëllim në jetë - që të kontrollojë tërë territoret që beson se historikisht i kanë takuar Kroacisë dhe për të arritur këtë ai do të bëjë gjithçka”, vërente Lordi Owen.

Tuxhmani nuk ishte interesuar as për bashkëpunimin me serbët e moderuar që mund të ishin si kundërbalanc me serbët e Krahinës, duke i lënë serbët e moderuar në ‘tokën e askujt’ - në mes nacionalizmit të Milosheviqit dhe vizionit të ngushtë të Tuxhmanit për ardhmërinë e Kroacisë. Tuxhmani kurrë nuk e ka pranuar Bosnjën si shtet. Ai besonte se ajo duhet të ndahet me Serbinë, në rastin më të mirë me një enklavë myslimane përreth Sarajevës.

Agjenda nacionaliste e Tuxhmanit përbëhej nga dy qëllime tipike të një regjimi nationalist: e para serbët në pozita t’i zëvendësonte me kroatë dhe e dyta,

mundësisht t’i zgjeronte kufijtë e Kroacisë. Ai korri sukses në të parin, duke bërë armiq serbët e moderuar në Kroaci, por dështoi në të dytin, ndonëse me Milosheviqin patën biseda të cilat i dhanë shpresë Tuxhmanit se Bosnja do të copëtohej.

Tuxhmani kishte ambicie edhe që të njihej si lider evropian. Por politikat e tij nacionaliste, stili bombastik, prirja për salltanet dhe për rrethana ët tjera, ai shumicës i lënte përshtypjen më shumë si sundimtar në operat komike sesa si lider i vërtetë.

Por kjo nuk i pengoi që të siguronte pushtetin gjatë viteve ‘90. Më kompleksi nga aktorët kryesorë në luftërat secesioniste ishte Slobodan Milosheviqi.

Më i hollë në sedrën politike sesa Karaxhiqi, më i përgatitur për negociata e diskutime sesa Tuxhmani, i gatshëm që për hir të pozitës politike të tradhtonte shokët apo aleatët dhe sharmant kur donte, Milosheviqi në karrierën e hershme nuk njihej për mbrojtje të nacionalizmit, siç ishte rasti me Tuxhmanin.

Në pranverën e vitit 1987 ai e kuptoi se mund të mobilizonte përkrahje të gjerë dhe entuziaste duke potencuar viktimizimin e serbëve sidomos në Kosovë.

Prej ardhjes në pushtet, në fund atij viti, ai perfeksionoi një agjendë të fuqishme nacionaliste që i shërbeu për atë besohet të ishte qëllimi i tij: të ketë pushtetin. Suksesi i tij për të siguruar përkrahje për politikën e tij për kontroll serb mbi



Në mars të vitit 1991 në Beograd ishte mbajtur një takim në të cilin sipas dëshmive të shumta Milosheviq dhe Tuxhman kishin biseduar për ndarjen e Bosnjes.

Kosovën, Vojvodinën dhe Malin e Zi me taktika brutale e shtyri të mendojë se ndoshta mund të marrë nën kontroll tërë Jugosllavinë. Kur kjo dështoi ai iu kthye një politike tjetër për të bashkuar tërë serbët e ish-Jugosllavisë, si ata të Bosnjës e Krahinës.

Këtu ai tregoi sens më të madh politik sesa çdo figurë tjetër. Dinte si të gjeneronte protesta publike që i përshtateshin planeve të tij dhe të prezentonte rrena të kulluara pa i luajtur syri. Dinte të negocionte, të jepte premtime të rreme dhe t’i lente kundërshtarët në hamendje.

(Nesër: Kur e arriti majën e pushtetit Milosheviqi? Cili ishte roli i mediave në mobilizimin e serbëve rreth Milosheviqit? Çfarë fjalori u përdor kundër popujve të tjerë të ish-Jugsollavisë?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (10)

Miqësia e prishur

Al Capone e dinte se dikush po e vidhte dhe dyshimet kishin rënë mbi ish-shefin e tij, Frank Yale. Derisa Capone po konsultohet me partnerët e tjerë në Chicago, Frank Yale, me flokë të lyera me briliantinë, rroba gri dhe mëngë të përvjela kishte dalë të pinte me lezet një kafe në Borough Park. Pa e mbaruar kafënë ra telefoni. Frank Yale u zbeh

Disa vjet më parë Al Capone kishte qenë kamerier në kafenenë e Frank Yalet në New York. Tani që Capone ishte bërë personalitet i fuqishëm i nëntokës - ishte viti 1928 - kishte nisur biznes të për-bashkët me Frank Yalen. Mirëpo, derisa Capone gjendej në Miami, Yale në anën tjetër po e vidhte.

Capone u konsultua me gjashtë partnerët e tij në Chicago lidhur me atë se çka të bënte lidhur me ish-shefin e tij. Rezultat i konsultës është pak a shumë kjo: Një të diel të bukur, më 1 korrik 1928, Frank Yale, me flokë të zeza të lyera me briliantinë, me rroba gri dhe mëngë të përvjelura, ishte duke pirë me qejf kafe në Borough Park, kur kamerieri ia kishte afruar telefonin. Askush nuk e di saktësisht se çka i ishte thënë në anën tjetër të telit, por Yale ishte ngritur me shpejtësi dhe kishte vrapuar drejt veturës së tij në parking. E kishte ndezur

veturën dhe ishte nisur me vrull. Mirëpo, nuk kishte arritur më shumë se te kthesa e parë. Një breshëri automatiku e kishte shpuar veturën bashkë me Frank Yalen brenda. Raportet e policisë thonë se ishin përdorur armë të ndryshme që nga pushkët e gjuetisë, revolet e deri te një armë e re e atëhershme e quajtur “tommy gun”. “Tommy gun” ishte një armë automatike me një karikator të rrumbullakët - çfarë është përdorur po e zëmë nga Tom Hanks në filmin “Road to Perdition”. Rasti i Frank Yales ishte i pari që një gangster të vritej me “tommy gun”. Pas kësaj, Al Capone sërish i ndali paralajmërimet për dalje në “pension”. Ai vazhdoi me biznesin me alkool, por duke e ditur se alkooli së shpejti do të legalizohej, vendosi të forconte rrjetin e tij të reketit.

Pronarë dyqanesh detyroheshin t’ia paguanin tatimin shtetit të Amerikës dhe

“haraçin” Al Capones. Nëse nuk ia paguanin tatimin shtetit edhe mund të shpëtonin disi. Nëse nuk ia paguanin haraçin Al Capones, dyqanet e tyre hidheshin në erë. Në këtë periudhë, me reket merrej edhe një tjetër i njohur i Al Capones - Bugs Moran. Bugs Moran ka qenë shok i ngushtë i dy personave që ishin



“Tommy gun” ishte një armë automatike me një karikator të rrumbullakët - çfarë është përdorur po e zëmë nga Tom Hanks në filmin “Road to Perdition”. Rasti i Frank Yales ishte i pari që një gangster të vritej me “tommy gun

vrarë nga Capone: Dion O’Banion dhe Hymie Weiss. Moran më parë kishte tentuar ta vriste mentorin e Capones, Johnny Torrinio dhe më pas kishte planifikuar ta vriste edhe kolegun dhe mikun e Capones, Jack McGurnin. Kur McGurn shko i vizitonte Al Caponen në Floridë atë dimër, vendosi t’i tregonte edhe për telashet me Bugs Moranin dhe bandën e tij. Capone dëgjoi me kujdes.

(Në numrin e nesërm: Çka vendosën Capone e McGurn lidhur me Bugs Moranin? Pse McGurn e kishte marrë nofkën “Mitrloz”? A kishte dashuri në ditën e të dashuruarve në vitin 1929? Cili ishte fati i Bugsit?)

Gangsterë të tjerë të shquar

Henry Hill

Të gjithë ata që e kanë parë filmin e Scorseses “Godfellas” e dinë historinë e Henry Hillit (në film rolin e tij e luan Ray Liotta). Hill ishte rritur në kohën kur familja Lucchese dominonte në Brooklyn dhe si djalë i ri kishte qenë i mahnitur me mafiozët. Kështu edhe vetë kishte nisur të rrinte me mafiozë. Ka punuar me kontrabandë dhe me reket. Mirëpo, e kanë arrestuar kur një ditë e kishte rrahur një shitës në dyqan që nuk kishte dashur të paguante reket. Për fatin e keq të Hillit, motra e shitësit kishte qenë agjente e FBI-së. Hill ishte dënuar me dhjetë vjet burgim. Sa ishte në burg, Hill nisi të krijonte ca lidhje të reja dhe pasi doli nisi të merrej me kontrabandë me drogë. Familjes Lucchese kjo gjë nuk i pëlqente dhe nisi sherri i tyre me Hillin. Hill vendosi që ta luftonte familjen Lucchese nëpërmjet gjyqit. Ai pranoi të dëshmonte kundër tyre në gjyq, me kusht që policia t’ia jepte një identitet të ri dhe një jetë të re. Henry Hill sot e gjithë ditën është i gjallë, por nuk dihet as emri i tij i ri e as vendbanimi.